



**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA:	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	6 - 23

**"IkubINFO International" shpk**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2024**

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	15,096,008	53,707,419
Llogari te arketueshme tregetare	5	26,478,417	93,558,276
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	6	38,813,145	-
Te tjera llogari te arketueshme	7	3,475,437	3,081,422
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>83,863,007</b>	<b>150,347,117</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	429,470	554,309
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>429,470</b>	<b>554,309</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>84,292,477</b>	<b>150,901,426</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari te pagueshme tregetare	9	2,283,864	3,973,671
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	10	70,229,837	55,072,472
Detyrime tatimore	11	1,332,642	5,507,352
Te tjera detyrime	12	2,991,644	6,319,526
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>76,837,987</b>	<b>70,873,021</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>76,837,987</b>	<b>70,873,021</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nenshkuar		2,400,000	2,400,000
Rezerva perkthimi		(7,265)	68,106
Rezerva ligjore		240,000	240,000
Fitime/humbje te mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		4,821,755	77,320,299
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>7,454,490</b>	<b>80,028,405</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>84,292,477</b>	<b>150,901,426</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



*dale* 2

**"IkubINFO International" shpk***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Konsoliduar e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	206,196,985	290,395,285
Te ardhura te tjera te shfrytëzimit	15	(4,105,845)	(10,260,200)
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>		<b>(101,535,784)</b>	<b>(97,302,683)</b>
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	16	(80,854,344)	(79,656,913)
2) Te tjera shpenzime	17	(20,681,440)	(17,645,770)
<b>Shpenzime të personelit</b>	18	<b>(95,203,891)</b>	<b>(101,229,310)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(85,217,835)	(90,653,425)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(9,986,056)	(10,575,885)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(124,839)	(161,872)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(910)	-
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime financiare</b>	20	<b>(49,362)</b>	<b>74</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)		(49,362)	74
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>5,176,354</b>	<b>81,441,294</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	21	<b>(354,599)</b>	<b>(4,120,995)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(317,061)	(4,074,589)
2) Zbritje te tjera per TF i paguar ne Kosove me norme me te larte		(37,538)	(46,406)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>4,821,755</b>	<b>77,320,299</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>			
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		(75,371)	68,106
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>(75,371)</b>	<b>68,106</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>4,746,384</b>	<b>77,388,405</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**"ikubINFO International" shpk**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Konsoliduar e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva Përkthimi	Fitime/humbje të mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022</b>	<b>2,400,000</b>	<b>240,000</b>	-	<b>(17,640,626)</b>	<b>45,338,993</b>	<b>30,338,367</b>
Fitimi / Humbja e vitit					77,320,299	77,320,299
Lëvizjet përmes kapitalit				45,338,993	(45,338,993)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			68,106			68,106
Dividendë të paguar				(27,698,367)		(27,698,367)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023</b>	<b>2,400,000</b>	<b>240,000</b>	<b>68,106</b>	-	<b>77,320,299</b>	<b>80,028,405</b>
Fitimi / Humbja e vitit					4,821,755	4,821,755
Lëvizjet përmes kapitalit				77,320,299	(77,320,299)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			(75,371)			(75,371)
Dividendë të paguar				(77,320,299)		(77,320,299)
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2024</b>	<b>2,400,000</b>	<b>240,000</b>	<b>(7,265)</b>	-	<b>4,821,755</b>	<b>7,454,490</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë aprovuar nga administratori i ikubINFO International shpk më 03.03.2025 dhe janë firmosur si më poshtë:



**Artan MALKA**  
Administrator

*Artan Malika*

**"IkubINFO International" shpk***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
<b><i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i></b>			
Fitim / Humbja e vitit		4,746,384	77,388,405
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzimet financiare jomonetare		3,308,940	6,632,900
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		124,839	161,872
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		27,872,699	(48,429,602)
Rënie/(rritje) në inventarë		-	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		9,272,072	22,508,109
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		(3,307,106)	2,510,578
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>42,017,828</b>	<b>60,772,262</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>			
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b><i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</i></b>			
Dividendë të paguar		(77,320,299)	(27,698,367)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		<b>(77,320,299)</b>	<b>(27,698,367)</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		(35,302,471)	33,073,895
Mjetet monetare në fillim të periudhës		53,707,419	27,266,424
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		(3,308,940)	(6,632,900)
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>4</b>	<b>15,096,008</b>	<b>53,707,419</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## "IkubINFO International" shpk

### Shënime të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në Lek)

#### 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "IkubINFO International" Shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë regjistrave të Qendres Kombëtare të Regjistrimeve me datë 20/03/2007. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr.7638 datë 19 Nentor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 2,400,000 leke i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

- Investment SHERKO - ikub GROUP 59.71%
- TAG Engineering shpk 40.29%

Administrator i shoqërisë është Z. Artan Malka.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Abdyl Frashëri, Hekla Center, Seksioni C, Kati 2-8, Tiranë. Ajo është e regjistruar në Degen e Tatimeve, Tiranë me NIPT K71702025M.

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është:

- Disenjim software-i. Analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software.
- Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suportit i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike.
- Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve.
- Aktiviteti i shërbimeve mbi software aplikative të zhvilluara nga vetë Shoqëria, ose software të tjera ku ka kompetencë.
- Aktiviteti i implementimit të sistemeve Database, Middleware, BI, Data Warehouse dhe platformave që shërbejnë për zhvillime aplikacionesh.
- Disenjim, programim, zhvillim, konsulentë, shërbime dhe veprimtari në fushën e sistemeve software GIS dhe WebGIS, strukturim dhe krijim i bazave të të dhënave hapësinore, zhvillime analizash.
- Aktivitet në shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së softwareve.
- Aktivitet në shërbime të përpunimit të të dhënave.
- Software si shërbim.
- Aktivitet në shërbime të hostimit të bazave të të dhënave dhe të dhënave përkatëse.
- Testim software. Testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software.
- Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN).
- Aktiviteti i shitjes së produkteve dhe shërbimeve që ka në objektin e veprimtarisë.
- Aktiviteti i shitjes së pajisjeve ICT.
- Aktiviteti i shitjes së licencave software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to.
- Konceptimi, zhvillimi, implementimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Import-eksport të mallrave, materialeve, shërbimeve etj. Tregtim elektronik dhe fizik i mallrave, materialeve, shërbimeve, të çfaredolloj natyre ato qofshin, të lejuara nga ligji. Aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira etj.

Më 31 dhjetor 2024 Shoqëria kishte 21 punonjës (2023: 47 punonjës).

Bazuar në Vendimin e Asamblesë nr. 1, datë 21.02.2023 u mor vendimi për krijimin e shoqërisë së huaj në Kosovë me emër zyrtar "ikubINFO International Sh.p.k Dega në Kosovë", Dege e Shoqërisë së huaj me numer biznesi 812021765. Qëllimi i krijimit të Degës së ikubINFO International Sh.p.k Dega në Kosovë në Republikën e Kosovës është të ushtrojë veprimtari të ligjshme tregtare në aktivitetet:

- Programim kompjuterik (primar)
- Këshillime kompjuterike (sekondar)
- Menaxhim i instalimeve kompjuterike (sekondar)



**"IkubINFO International" shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(Vlerat janë në Lek)

- Teknologji tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike (sekondar)
- Shërbimet e tjera të informacionit p.k.t (sekondar)
- Përpunimi I të dhenave, hostimi I informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to (sekondar)
- Web Portalet (sekondar)

ikubINFO International Sh.p.k Dega në Kosovë është mbyllur më 18.11.2024.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të konsoliduara".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkakuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.



*Jalho*

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara (vazhdim)**

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)**

#### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### **2.5. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>31 Dhjetor 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Euro/LEK	98.15	103.88
USD/LEK	94.26	93.94
GBP/LEK	118.16	119.47

### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.



### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

#### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.



**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

**3.4. Aktive afatgjata materiale**

*i. Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

*ii. Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Gjatë vitit financiar aktual, kompania ndryshoi metodën e amortizimit nga metoda mbi vlerën e mbetur, në metodën lineare. Ky ndryshim është bërë për të pasqyruar më mirë modelin e përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga këto aktive.

Ndryshimi në metodën e amortizimit është aplikuar në mënyrë prospektive nga 1 janar 2024, në përputhje me SNK 8.

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja fillestare e aktivit. Sipas kësaj metode, kostoja e një aktivi shpërndahet në mënyrë të barabartë gjatë jetës së tij të dobishme.



**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Normat e aplikuara te amortizimit per secilen kategori mbi vlerën e amortizueshme paraqiten si më poshtë:

<i>Ndërtesa</i>	5%
<i>Mobilje dhe orendi</i>	20%
<i>Mjetet e transportit</i>	20%
<i>Pajisje kompjuterike</i>	25%
<i>Makineri dhe pajisje</i>	20%

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetem qira operative.

**3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 5% ose 15% (2023: 5%/15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

#### 3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### 3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### 3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen fluksë dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### 3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare të konsoliduara. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



**"IkubINFO International" shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Mjete monetare në bankë	<b>14,713,193</b>	<b>53,707,419</b>
Llogari rrjedhëse	14,713,193	53,707,419
Mjete monetare në arkë	382,815	-
	<b>15,096,008</b>	<b>53,707,419</b>

**5. Llogari të arkëtueshme tregëtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Klientë	26,478,417	93,558,276
	<b>26,478,417</b>	<b>93,558,276</b>

**6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
ikubINFO shpk	18,000,000	-
	<b>18,000,000</b>	-

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Te tjera ikubINFO shpk	20,813,145	-
	<b>20,813,145</b>	-



*Handwritten signature*

**"IkubINFO International" shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**  
(Vlerat janë në Lek)

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Tatim fitimi	3,448,936	-
TVSH e kreditueshme	26,501	101,906
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	-	2,979,516
	<u><b>3,475,437</b></u>	<u><b>3,081,422</b></u>



**"IkubINFO International" shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**8. Aktive Afatgjata Materiale**

	<b>Mobilje e pajisje zyre</b>	<b>Pajisje informatike</b>	<b>Te tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>				
Gjendja më 1 janar 2023	423,331	6,339,126	3,569,561	10,332,018
Shtesa	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>423,331</b>	<b>6,339,126</b>	<b>3,569,561</b>	<b>10,332,018</b>
Shtesa	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2024</b>	<b>423,331</b>	<b>6,339,126</b>	<b>3,569,561</b>	<b>10,332,018</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
Gjendja më 1 janar 2023	(376,307)	(5,966,417)	(3,273,113)	(9,615,837)
Amortizimi i vitit	(9,405)	(93,177)	(59,290)	(161,872)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>(385,712)</b>	<b>(6,059,594)</b>	<b>(3,332,403)</b>	<b>(9,777,709)</b>
Amortizimi i vitit	(7,524)	(69,883)	(47,432)	(124,839)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2024</b>	<b>(393,236)</b>	<b>(6,129,477)</b>	<b>(3,379,835)</b>	<b>(9,902,548)</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>				
Gjendja më 31 dhjetor 2023	37,619	279,532	237,158	554,309
Gjendja më 31 dhjetor 2024	30,095	209,649	189,726	429,470



*Handwritten signature*

**9. Llogari të pagueshme tregëtare**

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Furnitorë	2,283,864	3,973,671
	<u>2,283,864</u>	<u>3,973,671</u>

**10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
<b><u>Të pagueshme tregtare</u></b>		
<i>ikubINFO</i>	-	17,857,699
<i>ikubINFO - Dega ne Kosove</i>	1,211,171	9,360,004
<u>Hua nga ikubINFO</u>	-	156,402
<b><u>Dividendë të pagueshëm</u></b>		
<i>Div.Investment SHERKO-ikub Group</i>	31,587,462	6,915,111
<i>Div.TAG Engineering</i>	37,431,204	20,783,256
	<u>70,229,837</u>	<u>55,072,472</u>

**11. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	778,762	1,747,772
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	488,497	2,330,262
Tatim në Burim	65,383	-
Tatim fitimi	-	1,429,318
	<u>1,332,642</u>	<u>5,507,352</u>



*Handwritten signature*

**"IkubINFO International" shpk****Shënime të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Vlerat janë në Lek)***12. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Detyrime ndaj personelit	2,991,644	6,298,750
Detyrime të tjera	-	20,776
	<u><b>2,991,644</b></u>	<u><b>6,319,526</b></u>

**13. Kapitali aksionar**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 2,400,000 leke.

Perberja e kapitalit të Shoqërisë, në fund të vitit 2024 dhe 2023, paraqitet si më poshtë:

Ortaku	<u>31 dhjetor 2024</u>		<u>31 dhjetor 2023</u>	
	Kuota %	Vlera	Kuota %	Vlera
Investment SHERKO	59.71	1,433,040	59.71	1,433,040
TAG Engineering shpk	40.29	966,960	40.29	966,960
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>2,400,000</b>	<b>100</b>	<b>2,400,000</b>

**14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>
Sherbime programimi e zhvillimi software	206,196,985	290,395,285
	<u><b>206,196,985</b></u>	<u><b>290,395,285</b></u>

**15. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera financiare, që detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>
Fitime nga këmbimet valutore	1,540,981	1,843,892
Humbje nga këmbimet valutore	(5,646,826)	(12,104,092)
	<u><b>(4,105,845)</b></u>	<u><b>(10,260,200)</b></u>



**"IkubINFO International" shpk**

**Shënime të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(Vlerat janë në Lek)

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 31, 2024</b>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne</b>	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	205,094,565
<b>Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH</b>	<b>205,094,565</b>
Shitje mallrash	-
Sherbime programimi	205,094,565
Të ardhura të tjera	-
<b>Te ardhura te deklaruar ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP</b>	<b>205,094,565</b>
Te ardhura nga Dega ne Kosove	1,102,420
Te ardhurat nga interesat	52
Fitim nga kembimet valutore	1,540,981
<b>Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit</b>	<b>207,738,018</b>

**16. Lëndet e para dhe shërbimet**

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</b>
Sherbime zhvillimi software	58,312,160	51,192,825
Sherbime konsulence software	22,542,184	28,464,088
	<b>80,854,344</b>	<b>79,656,913</b>

**17. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</b>
Sherbime konsulence	11,988,039	1,560,000
Shërbime telefonike+internet+postare	1,320	-
Komisione bankare	570,142	476,047
Taksa vendore	74,500	74,500
Shpenzime administrative	5,408,920	450,563
Shpenzime udhëtimi e dieta	999,975	-
Trajnime punonjësish dhe certifikime	451,506	-
Siguracione	-	147,595
Shpenzime per pritje	36,291	-
Shpenzime te ndryshme	1,150,747	14,937,065
	<b>20,681,440</b>	<b>17,645,770</b>



*[Handwritten signature]*

**"IkubINFO International" shpk**

**Shënime e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(Vlerat janë në Lek)

**18. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>
Shpenzime për paga	85,217,835	90,653,425
Shpenzime për sigurime shoq e shend	9,986,056	10,575,885
	<u>95,203,891</u>	<u>101,229,310</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2024 është 21 (2023:47).

**19. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>
Gjoha dhe penalitete	910	-
	<u>910</u>	<u>-</u>

**20. Shpenzime financiare Neto**

Shpenzimet financiare detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>
Të ardhura nga interesat	52	74
Shpenzime Financiare	(49,414)	-
	<u>(49,362)</u>	<u>74</u>

**21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shoqeria eshte subjekt i tatimit mbi te ardhurat ne Shqiperi.

Shoqeria zhvillon vetem veprimtari ne fushen e teknologjise se informacionit, ne keto kushte ne zbatim te Ligjit nr. 29/2023 "Per Tatimin mbi te Ardhurat" dhe te VKM Nr. 730, date 12.12.2018 "Per percaktimin e aktiviteteve qe perfshihen ne fushen e prodhimit/zhvillimit te software-ve, si dhe procedurat per aplikimin e tatim fitimit nga personat juridike qe ushtrojne keto aktivitete", shoqeria per vitin ushtrimor 2024 per aktivitetin qe ka ushtruar ne fushen e prodhimit/zhvillimit te software-ve ka aplikuar shkallen tatimore per Tatim Fitimin prej 5% sipas shkronjes ç, te nenit 69, te ligjit nr. 29/2023, "Per Tatimin mbi te Ardhurat", kurse per cdo aktivitet tjetër ekonomik, qe eshte ne fushen e teknologjise se informacionit por qe nuk eshte ne listen e aktiviteteve qe perfshihen ne fushen e prodhimit/zhvillimit te software-ve, shoqeria ka aplikuar shkallen tatimore per tatim fitimin prej 15%.

Ne perputhje me kerkesat e seksionit II te VKM Nr. 730 date 12.12.2018 shoqeria ka:

- Percaktuar ne statusin e kompanise si objekt veprimtarie, ndermjet te tjerave, edhe aktivitetet ekonomike te parashikuara ne piken 2 te kreut I te VKM Nr 730. Date 12.12.2018;



**21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)**

- Ka ne objektin e veprimtarise vetem aktivitete te teknologjise se informacionit, qe konsistojne dhe lidhen direkt me prodhimin, tregtimin dhe eksportin-importin e pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompjuterike hardware dhe software.

- Ka paraqitur prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane nje deklarate me shkrim ku ka paraqitur aktivitetin e objekt-veprimtarise se saj, per te cilat do te aplikojte shkallen tatimore 5%.

Formulet e deklarimit te tatimit mbi te ardhurat paraqiten cdo vit prane autoriteteve tatimore, por te ardhurat dhe shpenzimet te deklaruarua per qellime te tatueshme konsiderohen vete deklarime deri ne momentin qe jane vezhguar dhe vleresuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare jane subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Perlogaritja e shpenzimit per tatimin mbi fitimin paraqitet me poshte per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
	Aktivitet I tatueshem me 5%	Aktivitet I tatueshem me 15%	Totali	Totali
<i>Fitimi para tatimit</i>	5,176,354	-	5,176,354	81,441,294
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	1,164,856	-	1,164,856	50,484
Penalitet, gjoja e dëmshpërblime	910	-	910	-
Shpenzime të tjera pa dokumenta	1,163,946	-	1,163,946	50,484
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	6,341,210	-	6,341,210	81,491,778
Humbje fiskale e mbartur	-	-	-	-
Fitimi i tatueshem/ humbje fiskale	6,341,210	-	6,341,210	81,491,778
<i>Shkalla tatimore e tatim fitimit</i>	5%	15%	5%/15%	5%/15%
<i>Tatim fitimi @15%</i>	317,061	-	317,061	4,074,589
<i>Zbritje te tjera per TF i paguar ne Kosove me norme me te larte</i>	37,538	-	37,538	46,406
Fitimi/humbja e Vitit	4,821,755	-	4,821,755	77,320,299



*[Handwritten signature]*

"IkubINFO International" shpk

Shënime e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e konsoliduar e Performances e ndare sipas aplikimit të shkallës tatimore të tatimit mbi fitimin për vitin 2024:

	Total	Aktiviteti që aplikohet shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin prej 5%	Aktiviteti që aplikohet shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin prej 15%
	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	206,196,985	206,196,985	-
Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	(4,105,845)	(4,105,845)	-
<b>Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme</b>	<b>(101,535,784)</b>	<b>(101,535,784)</b>	-
1) Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme	(80,854,344)	(80,854,344)	-
2) Te tjera shpenzime	(20,681,440)	(20,681,440)	-
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>(95,203,891)</b>	<b>(95,203,891)</b>	-
1) Paga dhe shpërblime	(85,217,835)	(85,217,835)	-
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	(9,986,056)	(9,986,056)	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(124,839)	(124,839)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	(910)	(910)	-
<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	-
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>(49,362)</b>	<b>(49,362)</b>	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	(49,362)	(49,362)	-
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>5,176,354</b>	<b>5,176,354</b>	-
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>(354,599)</b>	<b>(354,599)</b>	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	(317,061)	(317,061)	-
2) Zbritje të tjera për TF i paguar në Kosovë me norme më të larta	(37,538)	(37,538)	-
<b>Fitimi i vitit</b>	<b>4,821,755</b>	<b>4,821,755</b>	-
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>			
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	(75,371)	(75,371)	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>(75,371)</b>	<b>(75,371)</b>	-
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>4,746,384</b>	<b>4,746,384</b>	-



*Handwritten signature*

**"IkubINFO International" shpk**

**Shënime të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(Vlerat janë në Lek)

**22. Transaksionet me palet e lidhura**

Balancat me palet e lidhura me 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
<b>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</b>		
<i><b>Te pagueshme tregtare</b></i>		
ikubINFO	-	17,857,699
ikubINFO - Dega ne Kosove	1,211,171	9,360,004
Hua nga ikubINFO	-	156,402
<i><b>Dividende te pagueshem</b></i>		
Div.Investment SHERKO-ikub Group	31,587,462	6,915,111
Div.TAG Engineering	37,431,204	20,783,256
	<u><b>70,229,837</b></u>	<u><b>55,072,472</b></u>
	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
<b>Të arketueshme nga palët e lidhura</b>		
<i><b>Të arketueshme tregtare</b></i>		
ikubINFO shpk	18,000,000	-
<i><b>Të arketueshme te tjera</b></i>		
Te tjera ikubINFO shpk	20,813,145	-
	<u><b>38,813,145</b></u>	<u>-</u>
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>
<b>Shitje ndaj palëve e lidhura</b>		
ikubINFO shpk	15,000,000	7,333,333
ikubINFO shpk - Dega ne Kosove	1,102,420	-
	<u><b>16,102,420</b></u>	<u><b>7,333,333</b></u>
<b>Blerje nga palët e lidhura</b>		
ikubINFO shpk	-	14,881,416
ikubINFO shpk - Dega ne Kosove	58,356,692	49,634,325
	<u><b>58,356,692</b></u>	<u><b>64,515,741</b></u>



*Handwritten signature*

**23. Angazhime dhe pasiguri**

*Çeshtje gjyqesore*

Gjate aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga pale të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2024 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

**24. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

